



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.397/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Obiliq, Shkurte Raçi nga radhët e subjektit politik LVV, me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 26.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa ZL.A.nr.397/2017, e kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal të Obiliqit, Shkurte Raçi nga radhët e subjektit politik LVV, me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, e paraqitur me datën 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Shkurte Raçi, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal të Obiliqit, nga radhët e subjektit politik LVV, me të cilat pretendon se i janë keqpërdorur votat, në Qendrën e Votimit të Komunës së Obiliqit, si në: nr.1520e/02D, në Mazgit të Epërm.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht rregullsinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudh si të parakohshme ankesën e ankueses. Hudhja e ankesës së ankueses Shkurte Raçi, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL. Anr.397/2017 më datën 26.10.2017



**Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi**

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*